



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:151785

Datë: 31.07.2024

Numri i dokumentit: 06005665

CAP.nr.432/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin individual Adnan Konushevc, në çështjen përmbare të kreditorit R.I nga Komuna e M... së V..., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit M.I, avokat nga Komuna e F..., Rruga “Driton Islami”, Nr.2, kundër debitorit XH.P nga P..., Rruga “Vëllezërit Fazliu”, Nr.337/A, për pagesën e mjeteve në emër të borxhit sipas Pajtimit Gjyqësor C.nr.54/2017 i datës 21.01.2020, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.332/23 i datës 19.01.2023, jashtë seance me datë 31.07.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e debitorit XH.P nga P..., Rruga “Vëllezërit Fazliu”, Nr.337/A, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.332/23 i datës 19.01.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.332/23 i datës 19.01.2023, ka vendosur si në vijim: “*Refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit XH.P i datës 03.11.2020 , i parashtruar kundër urdhërit përmbare ,të datës 20.10.2020 me numër P.nr.609/2020 i nxjerrur nga Përmbaresi Privat B.A, me selinë zyrës në Ferizaj*”.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës Kontestimore dhe vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, andaj i kanë propozuar Gjykatës së Apelit, që të aprovohet ankesa debitorit, t’a anulohet aktvendimin e shkallës së parë dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë muk ka paraqitur i autorizuari i kreditorit.

Gjyqtari individual i Gjykatës së Apelit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, përmes të autorizuarit të tij, me datë 20.10.2020, ka paraqitur propozim për përmbarim ndaj debitorit në bazë të dokumentit përmbarues ujdj gjyqësore me numër të lëndës 2019:083912, C.nr.54/2017 i datës 21.01.2020, për shumën e borxhit, prej 443,000.00 euro.

Organi përmbarues – Përmbaruesi Privat B.A në Ferizaj, e ka lejuar përmbarimin e propozuar nga kreditori me urdhrin P.nr.609/2020 i datës 20.10.2020.

Kundër këtij aktvendimi, debitori Komuna e Ferizajit ka paraqitur prapësim me propozim që prapësimi të aprovohet si i bazuar ndërsa të shfuqizohet aktvendimi me të cilin është lejuar përmbarimi.

Kreditori përmes të autorizuarit së tij ka parashtruar përgjigje në prapësim me të cilën ka propozuar që të refuzohet prapësimi i debitorit, ndërsa aktvendimi për lejimin e përmbarimit të lihet në fuqi.

Gjykata Themelore në Ferizaj –Departamenti i Përgjithshëm, duke vepruar sipas prapësimi të debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar, PPP.nr.332/20 i datës 19.01.2023, me të cilin e ka refuzuar si të bazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të te njëjtit.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pas shikimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës si dhe pretendimeve të debitorit dhe përgjigjes së kreditorit, gjeti se me rastin e nxjerrjes së aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit, në këtë çështje përmbarimore, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për caktimin e përmbarimit të propozuar nga i autorizuari i kreditorit dhe prapësimi i përfaqësuesit të debitorit është në tërësi i pabazuar.

Gjykata gjithashtu në arsyetim të aktvendimit ka theksuar se në rastin konkret mund ta bëjë vlerësimin e pajtimit gjyqësor vetëm sa i përket faktit nëse i njëjti është dokument përmbarimor apo jo por jo edhe ligjshmërinë e lidhjes apo nxjerrjes së pajtimit gjyqësor dhe në rastin konkret gjykata konstaton se pajtimi gjyqësor i cekur më lart i plotëson të gjitha kushtet ligjore nga neni 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, për tu cilësuar dokument përmbarimor. Më tutje gjykata ka konstatuar se pajtimi gjyqësor 2019:083912, C.nr.54/2017 i datës 21.01.2020, është i përshtatshëm për përmbarim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, për shkak se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha dhe mënyra e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) dhe m) të LPK,

dhe se drejtë janë zbatuar dispozitat ligjore, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK.

Pas vlerësimit të thënieve në ankesë, Gjykata e Apelit vlerëson se Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me vendosjen sikurse në dispozitiv të aktvendimit duke i vlerësuar të gjitha thëniet e debitorit si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës e duke dhënë arsye për çdo pretendim të refuzuar dhe çdo fakt që ka vërtetuar në lidhje me vendosjen sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë duke i vlerësuar pretendimet ankimore të parashtruar nga ana e debitorit, vlerëson se të njëjtat janë të pa bazuara për arsye se kjo Gjykatë gjen se aktvendimi për përmbarim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP-së dhe atë për faktin se propozimi për përmbarim është bërë në bazë të dokumentit të përmbarues – ujdisë gjyqësore përcaktuar me nenin 22 par.1 nën par 1.2 të këtij ligji i cili përcakton se: *“1. Dokumente përmbaruese janë: 1.1. vendimi përmbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përmbaruese;*, po ashtu Ligji për procedurën përmbarimore e përcakton edhe çka konsiderohet vendim i Gjykatës ku neni 23 par.1 përcakton se: *“1. Sipas këtij ligji, vendim gjyqësor konsiderohet aktgjykimi, aktvendimi, si dhe vendimi tjetër i dhënë në procedurën gjyqësore ose të arbitrazhit, kurse ujdi gjyqësor konsiderohet ujdia e arritur përpara Gjykatës dhe arbitrazhit si dhe marrëveshja e arritur në procedurën e ndërmjetësimit”*, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore të sipërcituara kjo Gjykatë vlerëson se urdhri për përmbarim është lëshuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe i përmban të gjitha elementet e përcaktuara me këto dispozita andaj nuk ekziston asnjë shkak që kjo Gjykatë të mos e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë si të drejtë dhe të ligjshëm.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se propozimi për përmbarim është bërë në përputhje edhe me nenin 36 par.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri.”* Pajtimi Gjyqësor në bazë të së cilit është bërë propozimi për përmbarim është bashkëngjitur përmban vulën për saktësinë e kopjes së vërtetuar te Gjykatës, pranë së cilës është lidhur ujdia gjyqësore.

Me anë të këtij pajtimi gjyqësor i padituri – tani debitori është i detyruar që në emër të borxhit lidhur për çmimin e shitblerjes së palujtshmërisë. ngastra kadastrale 1246, në sipërfaqe prej 6617 m<sup>2</sup>, ngastra kadastrale 1254/1, në sipërfaqe prej 4250 m<sup>2</sup> dhe ngastrën kadastrale XXXX, në sipërfaqe prej 2660 m<sup>2</sup>, të gjitha ZK Ferizaj, të paguaj shumën prej 443,000.00 euro, më tri këste të specifikuara më decidivisht në ujdinë gjyqësore për mënyrën e pagesës. Meqenëse debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ashtu siç është përcaktuar me pajtim gjyqësor, atëherë kreditori detyrimisht është dashur që të paraqes propozim për përmbarim në mënyrë që të realizojë detyrimin që e ka pasur debitori ndaj tij përmes përmbarimit.

Meqenëse debitori me ankesë nuk ka paraqitur asnjë shkak me të cilin do të vërtetonte se ekzistojnë arsyeje të cilat do të bënin dokumentin të pa përshtatshëm për tu përmbaruar, Gjykata

e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur e ka refuzuar prapësimin si të pa bazuar duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e konsideruar vendimin e gjykatës së shkallës së parë të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CAP.nr.432/2023 me datë 31.07.2024

Gjyqtari,  
Adnan Konushevci, d.v